



VENDIM

Nr. 67, Datë 11.05.2017

MBI

**MOS FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“BALKAN GREEN ENERGY” SH.P.K., NË AKTIVITETIN E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “ç” të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “d”; 5, pika 1 gërma “d”; 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për dhënie, Modifikimi, Transferimi, Rinovimi ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” të “Rregullave për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 11.05.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “BALKAN GREEN ENERGY” sh.p.k, në aktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut;

Konstatohet se:

Aplikimi i shoqërisë “BALKAN GREEN ENERGY” sh.p.k, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat (“a”, “b”, “c”, “d”, “e”), është plotësuar në mënyrë të pjesshme.
- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b” janë plotësuar; gërmat “c” dhe “d” të pa plotësuar.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, gërmat “a”, “b”, “c”, “e”, “f”, “a1”, “b1”, “c1”), është i pa plotësuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “BALKAN GREEN ENERGY” sh.p.k., në aktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE

Petrit AHMETI